




KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



NPL "EKO-THERANDA"  
SH.A. SUHAREKË

NPL EKO THERANDA SH.A.	
Nr.	02
Data	29.01.2025
SUHAREKË	

## KODI I ETIKES DHE QEVERISJËS KORPORATIVE

PËR

"EKO-THERANDA" SH.A. NË SUHAREKË

Suharekë 2025

Në bazë të dispozitave të neneve 35 dhe 137, të Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 9/2018”, e në pajtim me dispozitat e Kodit të etikës dhe qeverisjes korporatave për Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe ZM, Nr-509/2009 të datës, 30.04.2009, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.01.2025 miratoi këtë;

## **KODI I ETIKES DHE QEVERISJËS KORPORATIVE PËR “EKO-THERANDA“ SH.A NË SUHAREKË**

### **SEKSIONI I**

#### **OBJEKTIVAT DHE PRAKTIKAT**

##### **1. Të përgjithshme;**

Kodi për Qeverisjen e ndërmarrjes publike lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë (në tekstin e mëtejmë “Kodi”) ka për qëllim të promovojojë praktikat efikase dhe të përgjithshme për qeverisjen e “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë.

Në këtë kuptim, Kodi duhet të paraqes kriteret, që do të zbatohen nga organet e ndërmarrjes, ushtrojnë aktivitetin e veprimit, e cila u lejohet atyre me statut dhe Ligj të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

**1.1** Kodi duhet të lexohet në lidhje me kornizën rregullative të ndërmarrjes, e aplikueshme në Republikën e Kosovës, për të përfshire Ligjin, Nr-03/L-087 për Ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-31/2008), Ligjin Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, Nr-03/L-087, për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës”, Nr-13/2012) dhe Ligjin Nr-02/L-123, për Shoqërinë Tregtare, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-39/1, tetor 2008) dhe statutin e ndërmarrjes, ashtu siç plotësohet kohë pas kohe. Nëse ndonjë prej dispozitave në këtë Kod është në konflikt me dispozitat e dokumenteve të lartë përmendura, atëherë mbizotërojnë dispozitat e ligjeve të cekura me lartë.

**1.2** Fjalë- dhe shprehjet në statutin e ndërmarrjes do ta kenë të njëjtin kuptim dhe efekt atëherë kur përdorën në këtë Kod, vetëm në raste se shprehet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe.

##### **2. Natyrë obliguese dhe interpretimi;**

Kodi do zhë jetë i detyrueshëm për ndërmarrjen, Bordin e drejtorëve, zyrtarët e lartë dhe zyrtarët tjera të ndërmarrjes publike lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë.

## SEKSIONI II

### RAPORTI MIDIS ZYRTAREVE DHE BORDIT

#### 3. Përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv (KE)

**3.1** Kryeshei Ekzekutiv i ndërmarrjes do të përzgjidhet vetëm në bazë të meritës, veçan arisntë, Bordi i drejtoreve duhet të përzgjedh një kandidat që posedon aftësi për të kryer detyrat dhe përgjegjësit e tij/saj: i cili është i gatshëm dhe ka mundësi të implementojnë strategjinë e përcaktuar nga Bordi i drejtoreve dhe i cili ka aftësi të jep mendimin e tij objektiv dhe të pavarur në lidhje me interesin e veçantë të ndërmarrjes. Në këtë pikë, Kryeshei Ekzekutiv i ndërmarrjes duhet të përzgjidhet përmes një procesi të hapur, konkurruar dhe transparent, i organizuar si vijon:

**3.2** Bordi i drejtoreve do të përcaktojë kualifikimet minimale dhe të kërkuara për pozitën: kualifikimet e tillë duhet të janë specifike dhe të lidhura me nevojat e ndërmarrjes dhe sektorin në të cilin ajo operon:

**3.3** Shpalja e arsyeshme informative për vend të lirë pune, duhet të publikohet dy herë, më se paku në dy gazeta me të lexuara në Republikën e Kosovës dhe duhet të shpërnditet nëpërmjet mediave të tjera në Republikën e Kosovës dhe më gjërë:

**3.4** Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër sesa 15, ditë, që nga data e publikimit të shpalljes për vend të lirë pune:

**3.5** Bordi i drejtoreve duhet të udhëzojë një këshilltar të pavarur, kompetent dhe me reputacion, që të vlerësoje të gjithë kandidatet kundrejt kërkesave minimale dhe të krijoje një listë të ngushtë, sipas kualifikimeve të tyre profesionale:

**3.6** Bordi i drejtoreve duhet të vlerësojë dhe intervistojë një numër të mjaftueshëm kandidatësh (zakonisht, jo më shumë se 4):

**3.7** Procesi i përzgjedhjes duhet të përsëritet derisa Bordi i drejtoreve të identifikojë një kandidat të kënaqshëm.

**3.8** Kandidati i zgjedhur duhet të ketë besueshmërinë e plotë të Bordit të drejtoreve.

**3.9** Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Këshilltari i përgjithshëm /Sekretari korporativ do të përzgjidhen nga Kryeshei Ekzekutiv vetëm në bazë të meritës. Në këtë kuptim, kandidatët do të propozohen nga Kryeshei Ekzekutiv për t'u emëruar me pas nga Bordi i drejtoreve. Përzgjedhja do të bëhet përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurse, i krijuar lirshëm nga Kryeshei Ekzekutiv mbi bazë të analizës së kostove-përfitimeve dhe në pajtim me politikat e ndërmarrjes për rekrutim dhe në pajtim me Ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

#### 4. Kompetencat e Bordit të drejtoreve, KE-së dhe ZKFTH-së

**4.1** Bordi i drejtoreve duhet të sigurojë se KE-ja gjëzon fuqinë e mjaftueshme për menaxhirin konkret të afarizmit dhe detyrave të ndërmarrjes, duke pasqyruar përgjegjësinë e madhe të KE-së për përformançen e ndërmarrjes. Në veçanti, Bordi i drejtoreve nuk duhet të ndërhyjë, ose të sfidoje vendimet e KE-së, sa i përket rekrutimi; ose përashtimit të punëtoreve të ndërmarrjes, ose niveleve të tyre të pagave (tjetër nga ajo e zyrtarëve të ndërmarrjes). Përveç kësaj, anëtarët e bordit nuk

duhet t'u japin udhëzime punëtoreve të ndërmarrjes për çështjet që i përkasin ndërmarrjes, në rast se ata nuk veprojnë në kapacitetin e tyre si konsumatorë të ndërmarrjes. Me kusht që Bordi, si organ grumbullues, dhe i nënshtronhet dispozitave të këtij Kodit dhe statutit të ndërmarrjes, mund t'u jap udhëzime Zyrtarëve të ndërmarrjes.

**4.2** Bordi i drejtoreve do të kufizojë brenda kompetencave të veta përmes kërkesës për autorizimin e tij paraprak-vetëm për veprimet ose transaksionet me të rendësishme, te cilat parashtronë rreziqe për strukturën industriale ose financiare të ndërmarrjes, duke i identifikuara ato mbi bazat e natyrës dhe masave të tyre: transaksioret e tillë natyrisht do të përfshijnë përvetësimin dhe shitjen e bizneseve të mëdha ose degëve të tyre, të cilat përfaqësojnë se paku 10% të qarkullimit vjetor të ndërmarrjes, gjetjen e garantuesve, për detyrimet e mëdha dhe detyrimet tjera të hapura të palës së tretë.

**4.3** Ne çdo rast, Bordi i drejtoreve do të ruajë kompetencën për të marrë vendime ose për të autorizuar çështjet, që bien brenda menaxhimit ditorë të ndërmarrjes.

**4.4** Bordi i drejtoreve nuk do të shqyrtojë në detaje veprimet ose vendimet, që bien brenda menagjimit ditorë të ndërmarrjes, me përashtim të detyrave të saj për mbikëqyrje.

**4.5** Bordi i drejtoreve mund të kufizojë kompetencat e KE-së duke kërkuar nënshkrimin e KE-së vetëm në vendimet që kanë të bëjnë me veprimet ose transaksionet, të cilat deri sa janë të një madhësie të konsiderueshme (në kriterin e njëjtë të paraqitur në seksionin II.4 (2) me sipër), nuk krijojnë rreziqe të mëdha për strukturën financiare dhe industriale të ndërmarrjes.

**4.6** Bordi i drejtoreve do të sigurojë që KE-së të gjëzojë kompetencën e mjafueshme për të menaxhuar në mënyre të suksesshme çështjen financiare të ndërmarrjes. Bordi do t'i kufizojë të drejtat e KE-së vetëm në raste të marrjes së këtyre kompetencave për vetë brenda kufijve të përcaktuar në seksioni II.4 (2) të Kodit, ose në rast të kërkesës për nënshkrim të përbashkët me KE-në.

**4.7** Bordi i drejtoreve vendos që t'ia jap KE-së udhëzimet për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes, këtij të fundit nuk do t'i kufizohet liria e veprimit për të modeluar raportin e drejtpërdrejt, që sjell KE-ja. Në çdo rast, Bordi i drejtoreve, mund të vendos të mos ia japë KE-së udhëzimet e detajuara për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes publike lokale.

## **5. Detyra e mbikëqyrjes së Bordit të drejtoreve;**

**5.1** Bordi i drejtoreve do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë, veçanërisht, mbi sjelljen e zyrtarëve të ndërmarrjes (duke përashtuar zyrtarin e brendshëm për Auditim, i cili është në kompetencë ekskluzive të Bordit të Drejtoreve).

**5.2** Nëse përforma e ndërmarrjes i shmanget synimeve të vendosura në planin e biznesit të vitit të caktuar, atëherë Bordi i drejtoreve do të kërkojë një raport nga KE-ja, ku do të tregohen arsyet dhe sqarimet, për mosfunksionim të duhur dhe të mirrën masat e duhura përmirësuese.

**5.3** Në rast se ndërmarrja nuk i përbush synimet e saj realizues për dy vite financiare radhazi, Bordi i drejtoreve do ta largoje dhe zëvendësoje KE-jn, madje, edhe në raste të mungesës së dëshmive të qarta të neglizhencës, me përashtim të rastit kur del se mosrealizimi ka qenë rezultat i trethanave ose ngjarjeve të paparashikuarës në mënyre objektive.

## **6. Fuqizimi i detyrave të dhëna në mirëbesim të zyrtarëve;**

**6.1** Kurdo, që informacionet e besueshme dëshmojnë se ndonjë prej zyrtarëve (duke përashtuar zyrtarin e brendshëm për auditim, i cili është në kompetencë ekskluzive të Bordit të Drejtoreve) ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tij të besueshme, atëherë Bordi i drejtoreve do të hulumtojë çështjen pa vonesë dhe do të merr masa.

**6.2** Nëse Bordi i drejtoreve zbulon se një prej detyrave të besueshme të zyrtarit është shkelur, atëherë ai duhet të largoje dhe zëvendësoje menjëherë këtë të fundit, dhe të kërkojnë dëmshpérblim kundër tij/saj .

## **SEKSIONI III**

### **TAKIMET E BORDIT DHE ZYRTARIN E BRENDSHËM PËR AUDITIM**

#### **7. Takimet e Bordit të drejtoreve;**

**7.1** Bordi i drejtoreve do të përpiloj një orar të takimeve të rregullta, të cilat parashiherë të janë; jo me pak se 12 dhe jo më shumë se 24 takim të rregullta ne vit, të cilat do të mbahen në intervale të rregullta mujore. Bordi i drejtoreve duhet të krijoje rezultate me shkrim, vetëm atëherë kur kjo justifikohet në mënyrë objektive, se mbajtja e një takimi urgjent është i pazbatueshëm.

**7.2** Në sezonin takim të rregullt, Bordi i drejtoreve do të shqyrtojë dhe diskutoje se paku gjendjen financiare dhe përformancen afarishtë të ndërmarrjes, implementimin e planit të biznesit, planin e investimeve dhe raportet e Zyrtarëve të Lartë Ekzekutiv për transaksionet, vendimet dhe ngjarjet e periudhës përkatëse.

**7.3** Kryesuesi i Bordit të drejtoreve, do t'i shqyrtojë me kujdes dokumentet e dorëzuara për Bordin e drejtoreve, para takimit, në mënyre që te jetë në gjendje, të kërkoje shqipime ose informacione të tjera nga Kryeshefi Ekzekutiv.

**7.4** Takimet e jashtëzakonshme do të mbahen vetëm atëherë, kur thirren. Atëherë kur çështje të rëndësishme dhe urgjente kërkojnë zgjidhje nga Bordi i drejtoreve dhe çështja nuk mund të prese deri në takimin e planifikuar të radhës. Rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme duhet të thirret mbi çështjet që shtronhen në takim.

#### **8. Zyrtari i brendshëm për auditim;**

**8.1** Zyrtari i Brendshëm për Auditim, do të përgjidhet në bazë të meritës. Në mënyrë specifike Zyrtari i brendshëm për auditim duhet të përgjedh kandidatët që posedojnë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tyre. Përgjedhja do të bëhet nëpërmjet një procesi të hapur, transparent, konkurruesh dhe në pajtim me politikat për punësim të ndërmarrjes dhe Ligjin e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

**8.2** Mbikëqyrja e zyrtarit të brendshëm për auditim do të bëhet në pajtim me, tregullën, mutatis mutandis, tregullat e njëjtë të vendosura në seksioni II. 5 të këtij Kodi.

**8.3** Pagat e propozuara për KE, ZKFTH, Këshilltarin e përgjithshëm/Sekretarin korporativ, Zyrtarin e Brendshëm për Auditim do të propozohen nga Komisioni i Auditimit dhe do të vendosen nga Bordi i drejtorëve, në lidhje me pagën e KE, ZKFTH dhe Sekretari të ndërmarrjes/Sekretari i përgjithshëm-breda nivelistë pagave në treg, dhe në ndonjë rast-në nivelin që nuk dëmtohet mundësia e ndërmarrjes për të joshur kandidatët që kanë aftësitë dhe kompetencat e duhura.

**8.4** Zyrtar i brendshëm për auditim do të takohet para secilit takim të Bordit të drejtorëve, se paku tri ditë me heret dhe do të caktoje takimet në përputhje me rrethanat. Përveç kësaj Zyrtari i brendshëm për auditim do të caktojë çdo takim shtese, i cili mund të kërkohet për përbushjen e detyrave të tij.

**8.5** Në secilin takim që do të mbahet para takimeve të Bordit të drejtorëve, Zyrtari i brendshëm për auditim do të shqyrtojë - përveç dokumenteve të përgatitura në KE për Bordin e Drejtorëve - raportet nga zyrtari i brendshëm për auditim lidhur me çështjet e caktuara që bien brenda kompetencave të tij.

**8.8** Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve do të shqyrtojë me kujdese dokumentet e dorëzuara nga zyrtari i brendshëm për auditim, para mbajtjes se takimit, në mënyrë që të jetë në gjendje të kërkoje sqarime ose informacione të tjera, nga zyrtari i brendshëm për auditim.

**8.9** Takimet e jashtëzakonshme do të mbahen vetëm kur thirren, kur çështje të rëndësishme dhe urgjente kërkojnë një vendim nga Bordi i Drejtorëve dhe çështjet që nuk mund të presin deri në takimin e planifikuar të radhës. Rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme duhet të thirret mbi çështjen (et) për të cilat është thirrur ai takim.

**8.10** Për ta lehtësuar ushtrimin e mandatit të tij, Bordi i Drejtorëve mund të kërkojë edhe një konsultat të jashtëm, si këshilltar. Këshilltar i jashtëm duhet të ketë përvoje të duhur në praktikat e financave dhe kontabilitetit, bashke me njojurinë mbi praktikat rënë të mira për auditim.

**8.11** Bordi i Drejtorëve do të adoptojë tregullat procedurale, për trajtimin konfidencial të informacioneve të mbledhura, si rezultat i programit për denoncim, për shkak të hulumtimeve dhe trajtimit të akuzimeve të pavërteta.

## SEKSIONI IV

### DISPOZITA TE NDRYSHME

**9. Vetëvlerësimi i përformancës së Bordi të drejtorëve dhe Zyrtarit të brendshëm për auditim;**

Bordi i drejtorëve dhe Zyrtari i brendshëm për auditim, do të shqyrtojnë përformancat e tyre për çdo vite, në pajtim me kriteret përvlerësim, të krijuara në fillim të vitit finanziar dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

## **10. Deklarimi;**

Bordi i drejtorëve do të adoptojë, bashkë me pasqyrat financiare vjetore, një përbledhje të shkurtër, dhe një raport të thjeshtë gjuhësor, duke përbledhur në mënyrë të qartë, të drejtë dhe koherente pasqyrat financiare vjetore të ndërmarrjes dhe raportin vjetor, duke u përqendruar në të dhënrat, kryesore ngjarjet dhe vendimet e vitit përkatës financiar. Një raport i tillë do të përgatitet nga KE-ja dhe do t'i dorëzohet Zyrtarit të brendshëm për auditim dhe Bordit të drejtorëve, për miratim dhe do të publikohet në web-faqen e ndërmarrjes, bashkë me pasqyrat vjetore financiare.

## **11. Kodi i etikës, politikat për staf dhe udhëzuesi i punëtorëve;**

**11.1** KE-ja do të paraqesë para Bordit të drejtorëve një udhëzues për punëtorë, i cili duhet të përfshije kodin e etikës dhe politikat për staf, ashtu që, në mënyrë kolektive të sigurohet se ndërmarrja po i zbaton praktikat e qeverisjes së përgjegjshme dhe efikase në të gjitha fushat përkatëse.

**11.2** Bordi i drejtorëve kërkohet të respektoje dispozitat e zbatueshme të udhëzuesit të punëtorëve të ndërmarrjes, kusht që politikat vijuese të ndërmarrjes të janë të detyrueshme dhe të obligueshme për secilin anëtar të Bordit të Drejtorëve:

**11.3** Logot dhe mbishkrimet e ndërmarrjes nuk duhet të përdoren për letra personale ose për ndonjë qëllim jozyrtar të ndërmarrjes.

**11.4** Armët, duke përfshirë thikat, armët e zjarrit ose eksplozivet, nuk janë të lejuara në objektet e ndërmarrjes.

**11.5** Bordi i drejtorëve nuk duhet të pranojë të holla ose dhurata, materiale ose trajtime apo favorizime të tjera të veçanta, të cilat mund të krijojnë, ose duket se krijojnë, një pozitë favorizuese për dike që benë biznisë me ndërmarrjen, duke përfshire çdo individ, subjekt afarisht, ose agjencinë e cili është në pozitë për të ofruar mallra ose shërbime për ndërmarrjen. Me qëllim të këtij Seksioni, "dhurate" përcaktohet çdo gjë që ka vlerë, më të lartë se 50€.

**11.6** Besueshmëria: Gjatë mandatit të një anëtarit të Bordit, ai/ajo do të jetë kofidenciale ndaj informacioneve të ndërmarrjes, që kanë të bëjnë me: dizajnet e produkteve të dhënët për personelin e ndërmarrjes, parashikimet e ngarkesave, planet për kapacitet, dosjet e tarifave, strategjitet për marketing, informacionet për konsumatorë, politikat për caktimin e çmimit, dhe informacionet e tjera lidhur me këto. Këto informacione janë pronësore dhe kritike për suksesin e ndërmarrjes dhe duhet mos të dalin ose të përdoren jashtë objekteve të ndërmarrjes, ose të diskutohen me ndonjë punëtor jashtë ndërmarrjes, vetëm në raste se kjo lejohet nga KE, ose kur kërkohet me Ligj të zbatueshëm. Ky obligim do të vazhdojë edhe pasi të ketë përfunduar ose përashtuar mandati i anëtarit të Bordit.

**11.7** Marrëdhëniet me Publikun: meqë ndërmarrja duhet të flasë në një mënyrë të koordinuar dhe konsistencë, vetëm punëtoret e ndërmarrjes, të cilët janë të autorizuar me shkrim nga KE, mund të flasin para mediave lidhur më çështjen, që i takon ndërmarrjes. Të gjitha komunikimet me shkrim, me media, do të përgatiten nga zyrtari për marrëdhëniet me publikun dhe do të aprovohen nga KE para se këto komunikime me shkrim të dorëzojnë në media. Sipas kësaj, dhe në pajtim me këtë

politikë, anëtarët e Bordit duhet të mos flasin ose të dorëzojnë komunikata me shkrim për media, lidhur me gjërat që i përkasin ndërmarrjes.

**11.8** Anëtarët e Bordit caktohen me paga dhe përfitime vetëm nga Kompania, ashtu sic parashikohet me Ligjin e zbatueshëm. Në këtë pikë, dhe sipas dispozitave të Seksionit III. 8 (5) të këtij Kodi, ndërmarrja nuk do t'ju sigurojë (dhe anëtarët e Bordit nuk duhet të kërkojnë) këshilltarë, vetura, kompjuterë, telefon ose pajisje të tjera ose përfitime për Bordin e drejtoreve, e as t'u sigurojnë ndonjë zyre brenda objekteve të ndërmarrjes (përveç për qëllime të mbajtjes së takimeve të Bordit ose takimeve të Zyrtarit të brendshëm për auditim;).

**12.** Ky koç i etikës pas miratimit nga Bordi i Drejtoreve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë, i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm te ligjshmërisht nga Komisioni Komunal i Aksionarëve për të siguruar se kodi etikës në fjalë është në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikanë Kosovës.

**13.** Ky Koc i etikës hyn në fuqi 8, (tetë) ditë pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë.

### BORDI I DREJTORËVE

Nr. \_\_\_\_\_  
Me datë 29.01.2025





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA**  
**KOMUNA E SUHAREKËS**  
**OPSTINE SUVA REKA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKE**



BORDI I DREJTORËVE

Nr. 03

Data 31.01.2025

SUHAREKE

PËR/ ZA/TO:	Komisionin Komunal të Aksionarëve t NPL “Eko-Theranda” me seli në Suharekë
CC:	z. Bexhet KUÇI- Kryesues i Komisionit
PËRMES/ PREKO/THROUGH	
NGA/ OD/FROM:	<b>BORDI I DREJTORËVE I NDËRMARRJS PUBLIKE LOKALE “EKO-THERANDA” ME SELI NË SUHAREKE</b>
LËNDA/ SUBJEKT/SUBJECT:	Kërkesë për shqyrtim të përputhshmërisë së akteve normative
DATË/A:	31 janar 2025

Te nderuar,

Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” me seli në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.01.2025, ka miratuar 2 akte normative Ndërmarrjes Publike Lokale, “Eko -Theranda” me seli në Suharekë, si më poshtë;

1. Kodi i Etikës për ndërmarrjen në fjalë
2. Rregullorja për punën e Bordit të Drejtorëve për ndërmarrjen në fjalë.

Andaj në bazë ne në bazë të kompetencave dhe mandatit ligjor të përcaktuar konkretisht me dispozita e nenit 34, Ligjit, Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.31/2008” dhe nenit 20, të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2015”, kërkojmë nga ju që të bëni shqyrtimin e përputhshmërisë akteve të lartë cekura në afatin sa më të shkurtë.

Bashkangjitur më këtë shkresë keni; 2 (dy) aktet normative të cekura më lartë.

Ju faleminderit për mirëkuptim

